



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:068101

Datë: 05.01.2023

Numri i dokumentit: 03828841

C.nr.251/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. sh.a. (K.) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit R. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 375,68 €, jashtë shqyrtimit **me dt.24.08.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. sh.a. (K.) me seli në Prishtinë, ashtu që të **DETYROHET** i padituri R. H. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, që në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 375,68 €, (**treqind e shtatëdhjetë e pesë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent**) me kamatën përkatëse ligjore 8% në vit, e cila fillon të rrjedhë nga dt.24.08.2022 (data e marrjes së këtij vendimi) e tutje, e deri në pagimin definitiv si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **20,00 € (njëzet euro)**, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pala paditëse në padi ka theksuar se i padituri me qëllim që të sjellë vetit pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që në njehsorin elektrik ku përmes kabllor ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik dhe duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energjinë elektrike pa matje, me veprimin e tij i padituri i ka shkaktuar paditësit dëmin material në vlerë totale prej 374,39 €.

Në bazë të provave si Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, P.nr.153/2016, prej datës 25.04.2018, i padituri e ka pranuar fajësinë për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe i njëjti është dënuar me kusht.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt.22.10.2021, i ka dërguar të paditurit padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka pranuar personalisht Aktvendimin C.nr.251/20 të dt.22.10.2021, padinë dhe provat me dt.29.10.2021, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, të lartë cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u vendos komfor nenit 452.1 të LPK, me ç ‘rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 20,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr.251/2020, më datë 22.08.2022

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.